

Pasuria nga varfëria

Sokol Bylykbashi

Shoqëria e Kosovës vuan prej shumë dukurive negative. Ndër to janë korrupsioni dhe krimi i organizuar. Këto dukuri janë bërë sëmundje të rënda të cilat po shkaktojnë shumë të këqija sociale, ekonomike e politike. Për më tepër, këto dukuri po dëmtojnë fijet morale të shoqërisë sonë. Korrupsioni dhe krimi i organizuar si dukuri negative lulëzojnë aty ku institucionet janë të dobëta ose pothuaj joekzistente. Dhe kjo është e lidhur ngushtë me keqqeverisjen. Pra, këto dukuri negative lulëzojnë aty ku kontrolli e duhura ligjore mungojnë, ku nuk ka gjyqësi të pavarur ose mbikëqyrje, si dhe ku mediat e pavarura e profesionale dhe shoqëritë e shoqërisë civile janë të brishta.

Korrupsioni dhe krimi i organizuar shfaqen në shumë forma si: ryshfet, grabitje, reketim, mashtrim, trafikim, shpërdorim por edhe nepotizëm e favoritizim. Korrupsioni ndahet në dy grupe: korrupsion i vogël dhe i madh. Grupi i parë zakonisht përfshin shumica të vogla të paguara për zyrtarët e nivelit të ulët, ndërsa grupi i dytë përfshin pagesat e mëdha, të paguara për zyrtarët e lartë publikë ose politikëbërësve (duke përfshirë ministrat, kryetarët e agjencive të Qeverisë apo, madje, edhe presidentët e shteteve).

Korrupsioni ka pasojë negative për ekonominë, ngase është shkak dhe pasojë e moszhvillimit ekonomik. Një vend i korrumpuar i shkurajon investitorët e huaj potencialë dhe donatorët e ndryshëm publikë. Njohësi i ekonomisë nga Instituti francez për Studime Politike, Serge Michailof thotë se "suksesi i tërheq paratë, kurse dështimi dhe kaosi i përzë ato".

Politikëbërësit e Kosovës populli i quante "peshq të mëdhenj", sepse zhvasnin qindramijëra euro. Por sot ata mund t'i quajmë "peshkaqenë" sepse po keqpërdorin miliona. Këta politikanë janë pasuruar nga varfëria e popullit, duke e varfëruar edhe më shumë Kosovën. Në Kosovë ekzistojnë dy shtresa shoqërore - shtresa e pasur dhe shtresa e varfër. Grupit të parë i përkasin politikanët dhe bizneset që i kanë mirë punët me ta, ndërsa grupit të dytë i përket populli. Një shoqëri që nuk ka shtresë të mesme është sikur një njeri pa bosht kurrizor.

Politikanët e Kosovës përveç që janë të shkëputur nga populli politikisht, ata madje janë të shkëputur edhe në aspektin social e ekonomik. Pra, dallimi ndërmjet popullit dhe politikanëve është skajshmërisht i thellë. Politikanët bejnë jetë luksoze, populli bën jetë të

mjerueshme. Polikanët kanë vila dhe vetura të shtrejta, populli me veshtirësi e siguron bukën e gojës.

Institucionet më të korruptuara në Kosovë, sipas sondazheve ndërkombëtare e vendëse, janë KEK-u, Agjencia Kosovare e Privatizimit, gjykatat, doganat dhe administrata qendrore. Sigurisht që Qeveria është koka e korrupsionit. Departamenti Amerikan i Shtetit në raportin vjetor për gjendjen e të drejtave të njeriut thekson se korrupsioni dhe ndërhyrja e Qeverisë në forcat e rendit e sigurisë dhe në gjyqësor, mbeten ndër problemet kryesore në Kosovë. Të njëjtën gjë e thotë edhe organizata Freedom House në raportin e saj që u bë publik javën e kaluar.

Institucionet e korruptuara i udhëheqin njerëzit që marrin direktiva nga partitë politike. Këta njerëz punojnë për interesa partiake e jo për interesa qytetare, publike e shtetërore. Janë pikërisht këta njerëz të këtyre institucioneve që financojnë partitë politike në fushatat zgjedhore që janë shumë të kushtueshme.

Partitë opozitare po e kritikojnë ashpër Qeverinë për korrupsion e krim të organizuar, ata që po quhen liderë të opozitës, nuk ishin hiq më ndryshe se kjo Qeveri. Mbase dallimi mund të jetë vetëm në numra, ngase në kohën kur kanë qeverisur ata buxheti i Kosovës ka qenë më i vogël. Kësisoj ata nuk kanë mundur të vjedhin aq sa po vjedhin qeveritarët tani. Po të ishin në pushtet këta që tani po e kritikojnë Qeverinë e tanishme, do ta vidhnin popullin po aq sa këta që po qeverisin. Përvoja e lidhur na këshillon për këtë qëndrim.

Kryeministri e shpalli veten prijës të luftës kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar, ama Qeveria e tij ka ministra e zyrtarë që njëmend janë prijës të këtyre dukurive negative, dhe këta janë shokët e bashkëpunëtorët më të mirë të kryeministër dhe nuk bëjnë gjë pa dijeninë dhe miratimin e tij. Të korruptuarit nuk e luftojnë korrupsionin, sepse kjo do të ishte luftë kundër vetvetes.

Sistemin që e krijoi UNMIK-u në Kosovë përveç që ishte jodemokratik, ishte i korruptuar dhe i inkriminuar. Ky mision i OKB-së mbolli farën e korrupsionit dhe lejoi që krimi i organizuar të lulëzojë. EULEX-i, si UNMIK-u, bashkë me politikanët e Kosovës po e pamundësojnë zhvillimin ekonomik, dhe në çdo aspekt po e degradojnë jetën e popullit të Kosovës. EULEX-i që nga instalimi në Kosovë nuk ka bërë asnjë hap serioz për ta luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar. Këtij misioni iu deshtën më shumë se dy vite që të arrestojë disa zyrtarë të nivelit të ulët. Deri më tani asnjë zyrtar i nivelit të lartë nuk është



arrestuar dhe as që pritet që EULEX-si do të prangos ndonjërin prej tyre. Para pak kohësh Pieter Feithi fillimisht tha se do të kishte arrestime të "peshqve të mëdhenj" gjatë javës. Më pas thanë në muajin e ardhshëm. Kurse tash së fundi van Vreejswijk tha se të korrat do të vijnë në vitin 2011. Sa i përket zyrtarëve të lartë të cilët janë të përfshirë në korrupsion dhe krim të organizuar vlen slllogani famëkeq "hetimet vazhdojnë". Po pra, hetimet po vazhdojnë spikërisht

për të mos përfunduar. Dhe nuk do të përfundojnë deri sa faktori ndërkombëtar të mos bindet me hir a pahir se koncesionet politike për Kosovën më Serbinë kanë marrë fund. Kjo është arsya pse për zyrtarët e lartë nuk ka pranga: për ta do të ketë pranga kur Kosovës t'i heqen prangat. Politikanët zgjedhen nga populli për popullin, duke qenë të njëjtë me popullin. Në të kundërtën, nuk mund të flasim për demokraci e barazi.

Politika pa vullnet për sovranitet

Petrit Bajraktari

Jemi mësuar t'i shohim se si liderët e Serbisë vijjnë në Kosovë dhe shëtisin sikur këtu të ishte shteti i tyre, dhe pa pytur askënd. Më herët institucionet vendëse thonin se nuk jemi ende shtet dhe se me këto vizita po merrej UNMIK-u. Por, më vonë, pas 17 shkurtit 2008, na thanë që Kosova tashmë është shtet. E po të ishte kështu, atëherë edhe gjërat do të duhej të ndryshonin. Do të duhej që këto vizita të kriminelve serbë të ndalohen dhe festat e tyre që janë tradicionale në Serbi me prapavijë fashiste, të mos lejoheshin të mbahen edhe në Kosovë.

Gati çdo ditë, kryeministri, presidenti dhe kryeparlamentari na flasin për respektim të Kushtetutës dhe na tregojnë se po vepron sipas saj? Dhe kur pyten përse nuk po vepron ndaj vizitave të zyrtarëve nga Serbia, ata ose i ikin përgjigjes ose e shtrembërojnë atë. Kjo, pra, tregon më së miri se ne udhëhiqemi nga një elitë politike, e cila Kosovën e bën të mos duket si shtet. Po të ishim shtet normal nuk do të lejohej që kushdo dhe kurdo ta kalojë kufirin, dhe të hyjnë në vendin tonë, aq më tepër që te ne po hyjnë kriminelë nga Serbia me mbishkrime e parulla shovoniste.

Sërish shtrohet pyetja nëse institucionet vendore mund t'i ndalojnë këto vizita? Sjelljet e fundit po vërtetojnë se fuqia ekzekutive e ndërkombëtarëve është mbi këto institucione dhe mbi këta liderë. Në anën tjetër, ashtu sikurse gjithnjë, kësaj gjendjeje, përveç servilitetit të politikanëve vendës, po i ndihmon fakti që Serbia vazhdon të mbetet e përkdhelura e Evropës. Për këtë tregon edhe fakti se Serbisë iu mundësua liberalizimi i vizave, ndërsa Kosovës dhe Bosnjës që ishim viktimë të dhunës së organizuar të këtij shteti, u ndalohet një gjë e tillë.

Kush duhet t'i ndalojë këto vizita armiqësore? EULEX-i dhe Qeveria nganjëherë grinden sa për sy e faqe sa për ta larguar vëmendjen e opinionit nga ngjarja që ndodh. Një rast i ngjashëm ishte kur në Kosovë erdhi ish kryeministri serb, Vojislav Koshtunica, i përcjellë me roje të armatosura, që pati qëndruar në veriun e Mitrovicës, për të marrë pjesë në fushatën për zgjedhjet lokale që Serbia i organizoi në këtë qytet me 30 maj të këtij viti. Ndërsa Zyra e Përfaqësuesit të Bashkimit Evropian në Kosovë kishte konfirmuar se Kushtunica nuk ka kërkuar fare leje për vizitën e tij. Në

anën tjetër ishin nja dy-tre raste, kur politikanët serbë që kishin vizituar Kosovën në kapacitete zyrtare pa marrë leje paraprake, janë larguar nga ana e policisë së Kosovës. Kjo padyshim se ka qenë një orkestrim i mirë i vendorëve në bashkëpunim me ndërkombëtarët. Pra, ishte sa për sy e faqe. Ndërsa më rastin e po kësaj vizite, vetë ministri i Punëve të Brendshme Bajram Rexhepi, pati pranuar se Policia nuk ka mundur të veprojë në veri, për shkak të mungesës së kapacitetit të plotë. Ai pati deklaruar më 30 maj se ka kërkuar nga EULEX-i që të mos lejojë hyrjen e Kushtunicës. Ndërsa EULEX-i pati thënë se nuk është përgjegjës për të ndaluar vizita të tilla. T'ia rikujtojmë ministrit Rexhepi se ndoshta paska harruar që EULEX-i nuk ka interes që ta rregullojë atë pjesë të Kosovës për dy arsye. E para është se EULEX-i mbetet neutral ndaj statusit të Kosovës, pra nuk e njeh as këtë statusin që kemi momentalisht. Dhe, e dyta, është se EULEX-i ka ardhë në Kosovë me pelqimin e Serbisë, dhe të gjitha punët politike i bën në bashkëpunim të ngushtë më të, dhe në dëmin tonë.

Nga ana tjetër, Kosova është lënë jashtë lojës, duke mos pasë as qasje policore, as qasje doganore dhe asnje qasje tjetër atje. Thjesht, policia e Kosovës në pjesën veriore është inerte dhe pa rregulla policore, duke mos pasë qasje si organ mbrojtës i kontrollimit të kufirit, dhe në përgjithësi të asaj pjese.

Vizita të tilla armiqësore patëm edhe ditëve të fundit. Grupe kriminale serbe, pjesëtarë të së ashtuquajturës "Garda e Car Lazarit", "Obraz" dhe grupi tjetër "1389", sfiduan edhe një herë institucionet vendëse, dhe ato ndërkombëtare, duke marrë pjesë në manifestimin tradicional, për të cilin thamë se duhet ndaluar të mbahet këtu tek ne. Madje duke lëshuar hirje raciste si: "Duhet të vriten të gjithë shqiptarët që të mos ekzistojnë" si dhe "Kosova është Serbi dhe do të mbetet pjesë e shtetit serb" ata kërcënuan në tokën tonë, duke kërkuar gjakderdhje të reja në trojet shqiptare. Pra, merreni me mend - dikush vjen këtu tek ne, kërcënon hapur dhe Policia e Kosovës jo vetëm shikon anash, por edhe i siguron e përcjell shkelësit e sovranitetit. Ndërkaq në fund të ngjarjes kjo polici krejt çka bënë është dalja para mediave duke lëshuar deklarata idiotike se "manifestimi ka kaluar pa incidente". Sa për policinë e EULEX-it as që duhet pritur ndonjëherë që ata t'i kryejnë punët e shtetit të Kosovës.

Pra, këta kriminelë serbë, më 28 qershor erdhën në manifestimin e tyre, në shënimin e Betejës së Kosovës. Edhe pse dihet që serbët në këtë betejë ishin thyer turpshëm nga Perandoria Osmane, ata megjithatë e kremtojnë këtë me njëfarë krenarie, duke e konsideruar si një fitore të tyre. Për me keq, këto grupe kriminale dyshohet se në Kosovë kanë hyrë të armatosura. Pikërisht ky grup kriminelësh me emrin "Garda e Car Lazarit" gjatë marshimeve të tyre në ditët kur Kosova shpalli pavarësinë mbikëqyruar, kishin deklaruar se janë nga Kosova, dhe që do të "organizohen përseri që ta rimarrim atë". Ky grup kriminelësh me siguri është një nga ato grupet e shumta pjesëtarë të të cilit kanë kryer masakra mbi shqiptarët gjatë luftës në Kosovë 1998-99. Ndërsa sot vizitojnë vendin ku kan kryer krime, e në anën tjetër organet shtetërore flejnë, dhe shohin ëndrra syhapë. Ata është dashtë të ndalohen në kufi, dhe nëse për asgjë tjetër, do të duhej të ndaloheshin vetëm pse bartnin me vete fotografinë e kryekriminelit Milosheviq, shteti i të cilit bëri masakra masive mbi popullin shqiptar. Dhe paramendojeni si ndihen ato familje më të dashurit e të cilëve ishin masakruar nga paramilitarët serbë, me urdhër të atij që shihej në atë foto. Askush nga politikanët nuk doli që, të paktën, të thotë diçka, e lëre të jep urdhër për t'i ndaluar. Imagjinoni çka do të ndodhte sikur ne shqiptarët do të shkonim me një vend të banuar me serbë në Serbi, dhe të këndonim këngë kundër serbëve dhe kundër Serbisë?!

Jam i bindur se këto institucione, që nuk reagon kundër serbëve, do të reagonin kundër shqiptarëve në një situatë të ngjashme. Ndërsa shumë të tjerë do të përfundonin nëpër burgje. Kjo është marri e llojit të vet se çka po ndodh me Kosovën. Kjo është kulmi i së keqes. Dhe kjo si pasojë e institucioneve pa vullnet për ta mbrojtur vendin dhe interesat qytetare. Ndërsa nga këta politikanë dëgjojmë gjithë ditën duke folë për shtet e sovranitet. E që të dyja nuk shihen askund, derisa kaq shumë ngjarje të të dëmshme ndodhin në vendin tonë.

Kjo duhet të ndalohet një herë e përgjithmonë. Por jo nga këta politikanë të pavullnetshëm. Vizitat e bandave kriminale serbe, por jo vetëm kaq, mund dhe do t'i ndalojë vetëm një forcë e re politike që do të duhej patjetër të vihet në krye të vendit. Ata, mbi të gjitha, do të kishin vullnet dhe guxim për ta mbrojtur atdheun e tyre dhe për ta çuar përpara atë.

Betonimi i Serbisë për negociata me Kosovën

Sulmi i fundit në Lagjen e Boshnjakëve është pjesë e një skenari më afatgjatë politik të Serbisë për Kosovën. Protestat e organizuara nga strukturat paralele të Serbisë në atë pjesë të Kosovës kundër hapjes së zyrës së Qeverisë së Kosovës atje, synojnë t'ua bëjnë me dije të gjithëve, por veçanërisht institucioneve të Kosovës, se nuk ka shtrirje të pushtetit të Kosovës atje. Madje vetë mënyra se si institucionet e Kosovës po synojnë ta shtrijnë pushtetin e tyre atje po e thotë në mënyrë të tërthortë të njëjtën gjë.

Hedhja e një granate dore në këtë protestë nuk është e qëllimshme. Kjo po bëhet pikërisht në një kohë shumë të përshtatshme për Serbinë. Që prej vitit 2008 kur Kosova e shpali pavarësinë (e cila mbeti aty ku u nis, në shpallje), Serbia aktivisht e kundërshtoi këtë shpallje në dy rrafshë: brenda dhe jashtë Kosovës. Brenda Kosovës ajo i përdori strukturat e saj paralele, në të cilat kishte investuar që prej vitit 1999 dhe pikërisht për këto kohëra dhe nevoja të këtilla, për ta parandaluar shtrirjen e institucioneve të Kosovës nëpër ato pjesë të territorit të vendit. Natyrisht që angazhimi i këtyre

strukturave dallonte në formë dhe intensitet të agresivitetit, varësisht prej pjesës së Kosovës ku ato vepronin. Në veri ato uzurpuan dhunshëm secilin objekt, infrastrukturë dhe shërbim publik, për të treguar se atje kontrolli është në duar të tyre. Në pjesët tjera të Kosovës të banuara me serbë, Serbia shtronte rrugën infrastrukturore për decentralizimin të cilin do t'ia realizonin Hashim Thaçi me ministrat përgjegjës, si dhe për ndërlikimin territoriale të komunave me shumicë serbe, po ashtu me ndihmën e Qeverisë së Kosovës. Këto komuna i fitoi dhe krijoi falë këmbëngulësisë së Hashim Thaçit, Sadri Feratit, Pieter Feithit, dhe të tjerëve si këta. Ndërkohë që jashtë Kosovës, Serbia u angazhua për krijimin e një atmosfere diplomatike kundër Kosovës, për ta fituar edhe një proces negociator për Kosovën. Në Vjenë e fitoi të drejtën për të ndërhyrë brenda Kosovës, dhe kjo i pëlqeu shumë Serbisë. Tash po e përdor këtë të drejtë, për negociata të reja, që nënkupton për ta thelluar të drejtën për ndërhyrje dhe kontroll përmbi pjesë të territorit të Kosovës. Pushtetin e ka konsoliduar

dukshëm në Anamoravë me komunat e decentralizimit. Tash Serbia dëshiron sulme kundër serbëve në Kosovë – për ta zbrapsur Qeverinë e Kosovës nga veriu dhe për ta rregulluar perceptimit e situatës atje sipas nevojave të saj. Por as Hashim Thaçi nuk është shumë kundër një situatë të tillë. Ai, dhe të gjithë krerët politik pa dallim, i pranuan negociatat e reja me Serbinë pa kurrfarë ngurrimi. Atyre u nevojiten këto negociata për shkak se ua vazhdojnë pushtetin (bëhen më të përdorshëm për ndërkombëtarët kur i pranojnë negociatat, dhe e tërheqin vëmendjen e popullit të Kosovës nga uzurpimi dhe privatizimi i përhershëm i

resurseve natyrore dhe kompanive publike të vendit). Por pranimin e negociatave nuk kishin se si ta arsyetojnë. Çfarëdo acarrimi i situatës në pjesën veriore të Kosovës është arsye e mirë për Qeverinë e Kosovës dhe negociatat e pranuar. Se negociatat me Serbinë mund të ndodhin vetëm në një situatë të tillë, kur Serbia e betonon praninë e saj në veri, gjë që ua mundëson institucioneve të Kosovës t'i shesin negociatat me të kinse për zbutjen e këtij betonimi, që në fund të thonë se tentuam por ishte e pamundur për shkak se Serbia ishte betonuar. Shfaqje e vjetër kjo. Dhe me aktorë të vjetër.



Glauk Konjufca

(Në vend të recensionit për librin e Shkëlzen Gashit – Adem Demaçi: Biografi)

Në kohët e sotme të hipokrizisë së kudondodhur dhe të cinizmit të rafinuar postmodern, sa zor është ta gjesh njeriun që e mishëron madhështinë e njësimi të filozofisë jetësore me atë politike. E megjithatë, ne shqiptarët e kemi këtë njeri. Është Adem Demaçi. Njëjtësim i jetës me politikën, i ekzistencës me botëkuptimin. Jeta e tij është politike; politika e tij jetësore. Demaçi është një sintezë gati e përkryer e qenies dhe e mendimit. Së fundi, pikëpamjen tonë për këtë figurë të rëndësishme politike të rezistencës dhe të luftës për liri, e rikonfiguroi libri i vyer dhe aq shumë i munguar i Shkëlzen Gashit – *Adem Demaçi: Biografi*. Libri na sjell shumë të padëgjua për jetën e Demaçit, ashtu qysh na e rrëfen vetë ai, por edhe hollësisht të ndryshme të qëmtuara prej Shkëlzenit gjatë hulumtimit të tij të palodhshëm e sistematik gati dyvjeçar.

Kjo biografi i shter lakmueshëm të gjitha fushat e jetës, të veprimtarisë dhe të mendimit politik të Adem Demaçit, duke kapur një kohështrirje gjithëpërfshirëse të denjë për një jetëshkrim të kompletuar. Aty do ta gjesh fëmijën e mprehtë e adoleshentin e guximshëm, të pjekurin idealist e plakun e matur Adem Demaçi, birin e shpirtit e vëllanë e zemrës, babanë tragjik e bashkëshortin e largët, shokun e burgut e mikun e shtëpisë, udhëheqësin politik e njeriun e mendimit. Aty janë ëndrra, rrita, përpjekja, qëllimi, zhgënjimi dhe lartësimi i Adem Demaçit. Më intrigoj një fakt i çmuar që e ka sjellë autori: gjatë viteve të burgut, njëri prej filozofëve të cilin Demaçi e ka lexuar vazhdimisht, dhe me mësimin e të cilit ai e lidh filozofinë jetësore dhe mendimin e tij politik, është filozofi i madh i idealizmit gjerman, G. W. F. Hegeli. Në trajtimin e mëposhtëm neve do të na interesojë kryesisht jeta dhe mendimi i Demaçit në raport me filozofinë hegeliane. Meqë mund të thuhet se libri e Shkëlzenit ngërthen pothuase krejt jetën e Demaçit, atëherë ky vështrim rreth këtij libri le të jetë, në fakt, vështrim i jetës dhe i veprimtarisë së Demaçit nëpërmjet Hegelit.

Te vepra e mirënjohur e Hegelit, *Fenomenologjia e Frymës*, gjendet një nënkapitull i shkurtër i quajtur “Pavarësia dhe varësia e vetëvetëdijes: Zotëria dhe Skllavi”. Sipas disa interpretuesve të Hegelit (Marcuse, Kojevë, Hyppolite, etj.) kjo pjesë e *Fenomenologjisë* voluminoze ka qenë shkaktare e një stuhie tronditëse në filozofinë dhe mendimin politik kontinental të dy shekujve të kaluar. Aty Hegeli bën kapërcimin e famshëm gnoseologjik prej fushës së Vetëdijes në atë të Vetëvetëdijes, prej subjektivitetit te ndërsubjektiviteti, prej subjektivitetit te ndërsubjektiviteti, prej subjektivitetit te ndërsubjektiviteti kantian te Fryma Universale. Në këtë kapërcim përfundon rrëfimi idilik kartezian i *cogito*-s, të cilës nuk i nevojitet përvoja, ose i subjektivitetit kantian të cilit nuk i duhet Tjetri, dhe fillon koncepti hegelian i “Substancës që bëhet Subjekt”, i të “Vërtetës si Tërësi” dhe i Historisë si Aktualitet.

Duke iu referuar interpretimit të rëndësishëm të Kojevëit, përmbajtja e kapitullit shkurtimisht është kjo: çasti i hyrjes në përmasën e intersubjektivitetit e zhvendos të vërtetën prej fushës së izoluar njohëse të subjektivitetit te marrëdhënia me

Baca hegelian?

Tjetrin, që e prodhon aktualitetin. Kjo ndeshje fillestare na shfaqet si imponim i ndërsjellë vullnetesh. Këtë përpjekje luftarake të dëshirave njerëzore për ta mbizotëruar njëra-tjetrën Hegeli e quan “luftë për praninë”. Vjen një moment i rëndësishëm në historinë e kësaj përpjekjeje, dhe njëri prej vullneteve më parë e pranon vdekjen sesa nënshtrimin, kurse tjetri me çdo kusht rreket për jetën dhe ekzistencën. I pari është Zotëria, i dyti Skllavi. Zotëria është i pavarur nga jeta, prandaj e zotëron atë. Skllavi është i varur nga jeta, prandaj është rob i saj. Por Hegeli thotë se jo Zotëria, por Skllavi është subjekti i vërtetë i Historisë. Skllavi që ngrihet nëpërmjet përpjekjes vetanake, skllavi që nëpërmjet aktivitetit dhe disiplinës arrin të dalë nga lëvizja e vet e skllavërisë, skllavi që bëhet njeri në ballafaqim të vazhdueshëm me Zotërinë. Jeta, nënshtrimi, vdekja dhe liria janë të pandashme.

Demaçi e ka kuptuar Hegelin drejt: ne bëhemi njerëz në masën që arrijmë ta vëmë veten në funksion të lirisë. Rrugat e liria kapërcen nëpërmjet “rrezikimit të jetës”, siç do të thoshte Hegeli, kurse vdekja e vërtetë vjen atëherë kur jeta dëshirohet mbi të gjitha dhe me çdo kusht. E gjithë jeta e Adem Demaçit është një odiseadë rropatjesh cflitëse për ta vetëdijësuar popullin e vet se liria e vërtetë kurrë nuk arrihet po hyri në llogari jeta përpara lirisë. Hedhja e jetës në plan të dytë është parakushti i lirisë. Jeta që domosdoshmërisht përpiqet të mbetet në plan të parë, do ta humbasë lirinë herëdoherë, sepse është një jetë që paraprakisht ka treguar se mundet edhe pa atë që është në plan të dytë, mundet edhe pa atë që s’është e domosdoshme për të: mundet pa lirinë. Hegeli thotë që jeta e cila qëllimin e saj më të lartë e ka vetveten është jetë shtazore, jetë e reduktuar në përmasën e saj të zhveshur, jetë e funksioneve minimaliste natyrore, jetë e të mbeturit gjallë, jetë biologjike – aty ku njeriu takohet me bubrecin e gjarprin, majmunin e elefantin. Ashtu siç e sjell Shkëlzenin në libër, Demaçi këta i quan njerëz që s’mund ta japin as gishtin e vogël për liri. Kurse jeta njerëzore është ajo e cila mund të ngrihet mbi vetveten, ajo që më parë zgjedh ta mohojë vetveten sesa ta pranojë nënshtrimin. Edhe Adem Jashari ka mundur të mbeste gjallë, vetëm se i ishte dashur t’i pranonte disa kushte: dorëzimin e armës dhe të lirisë, pra nënshtrimin, jetën shtazore. Hegeli për Adem Jasharin do të thoshte: po ta kishte zgjedhur ai jetën si shumë të tjerë, do ta kishte zgjedhur vdekjen, por e zgjodhi vdekjen, prandaj u përjetësua dhe e bëri Historinë. E “Historia është Gjykata e Botës”, thotë Hegeli. Ata që kanë jetuar sa për të jetuar, ata në të vërtetë vetëm kanë vegjetuar, kurse “njerëzit e historisë botërore” e kanë çuar historinë njerëzore përpara. Të parët bëhen ushqim i vetëdijes historike të njerëzimit, të dytët ushqim i krimbave. “Historia është përmbushje e vetëdijes mbi Lirinë”, shkruan Hegeli te Filozofia e Historisë.

Demaçi, si një lexues i vëmendshëm i Hegelit, e ka kuptuar që nuk mund të kesh kurrfarë themeli të dinjitetit përpara armikut, e as marrëdhënie njerëzore me mikun, pa e ndërmjetësuar jetën nëpë-

rmjet vdekjes. Demaçi shumë herë kishte qenë pranë vdekjes, kurse Shkëlzenin na i sjell dy raste konkrete kur Demaçi ua qet gjoksin përpara ushtarëve serbë dhe u kërkon të shtien mbi të. Vetëm një njeri i tillë është çliruar absolutisht prej çfarëdo frike nga “Zotëria absolut – vdekja”, do të thoshte Hegeli, prandaj vetëm të tillët mund të ndjehen të barabartë e të paepshëm para armikut. Duke qenë të tillë, ata nuk e durojnë mospranimin, poshtërimin, diskriminimin, etiketimin... Kjo është arsyeja pse Demaçi e përzuri nga zyra e vet Përfaqësuesin e OKB-së për të Drejtat e Njeriut, çekun Jiri Dienstbier, kur ky i fundit e quajti UÇK-në grup terroristësh, rast të cilin e sjell Shkëlzenin në libër.

Por sado hegelian të jetë Demaçi, prapëseprapë ekziston në këtë njeri një tendosje e vazhdueshme mes panteizmit hegelian objektivizues – në të cilin kanë vend për t’u strehuar të gjitha kundërthëniet e kësaj bote – dhe dialektikës së çarjes, ndërhyrjeve radikale subjektive, përplasja e të cilave e prodhon Historinë dhe Aktualitetin si Racionalitet. Historia e mendimit dhe veprimi politik të Demaçit është kalimi i dhimbshëm prej dialektikës së çarjes te panteizmi i pajtimit harmonik të të kundërtave, i mbytyes së përpjekjes dhe i përballjes subjektive në objektivitetin e ecjes progresive të procesit, i tërësisë harmonike të përbërë nga pjesët ndërplotësuese.

Në fillim Demaçi na ka mësuar se nuk ka kompromis me lirinë, e kjo do të thotë se për lirinë nuk negociohet – liria si kërkesë është joprogresive, ajo nuk merret me rata: lirinë o e ke, o s’e ke. Si proces ajo është objektivisht progresive, por është e tillë vetëm duke u gjeneruar nga një përpjekje politike subjektive joprogresive e pakompromis dhe ultimative. Kosova e fitoi autonominë e vitit 1974 vetëm pas rezistencës shqiptare, e cila tregoi gatishmëri për sakrificë kapitale, sidomos pas vitit 1968 (natyrisht u kombinuan edhe faktorë të tjerë si vullneti për pushtet i Titos, së bashku me qëllimin e dobësimi të mbisundimit serb, etj.). Edhe pse më 1968 u kërkua “Kosova Republikë”, rezultati qe Kosova autonomi. Por kur ndodhi autonomia si kompromis, kjo ia krijoi kushtet e volitshme pushtetit jugosllav që ta godiste pa mëshirë elementin kombëtar shqiptar, i cili qëndroi pas kërkesës “Kosova Republikë”. Kosovës iu dha autonomia pikërisht për të mos iu dhënë Republika. Sa më shumë hapësirë për autonomistët, aq më e pamundshme manovra për republikanët. Kur Adem Demaçi u lirua nga burgu i dytë më 1974, në sytë e progresivistëve për të cilët autonomia paraqiste hapin vendimtar para republikës që po vinte, ai do të jetë dukur një i çmendur mazohist që po sakrifikohte kot së koti. Sa vështirë duhet ta ketë pasur Demaçi në atë kohë kur, siç e sjell Shkëlzenin në libër, askush nuk i fliste rrugës, pakkush guxonte ta vizitonte në shtëpi, i qenë pakuar miqtë dhe larguar njerëzit. E megjithatë, ai jo vetëm nuk u thye, jo vetëm qëndroi, por më shumë se kaq – ai na e dha një mësim të vlefshëm që arrin majat e përpjekjeve universale njerëzore për liri, të vlefshëm sidomos sot: u kryengrit pikërisht kur Kosova po dukej se po shkonte përpara,

sulmoi kur shumica mendonin se liria politike po rritej dhe gjendja po përmirësohej. Jo rastësisht pushteti jugosllav e goditi më keq se herave të tjera, sepse e krijoi klimën e përshtatshme për shkatërrimin e elementit kombëtar, meqë duke u dhënë shqiptarëve autonomi, e izoloi “pakicën irredentiste” nga masa oportuniste. Kur e luftoi mizorinë e hapur të Rankoviç-it, Demaçi u dënua më pak sesa kur u ngrit kundër autonomisë dhe “vëllazërim-bashkimit”. Herën e parë ai po e shënjestronte padrejtësinë e vetëkuptueshme e të tejdukshme, kurse herën e dytë po i sulmonte iluzionin dhe maskën. Kjo doli të jetë më e pafalshme, sepse për shqiptarët Jugosllavia paraqiste një përbindësh kriminal të fshehur nën maskën e “barazisë”, të “marksizëm-leninizmit”, të “socializmit vetëqeverisës”. Demaçi u përpoq t’ia heqte maskën dhe për këtë veprim u dënua me 15 vjet burg më 1975.

Gjatë kësaj kohe të veprimtarisë politike, Demaçi është në pikën kulmore të dialektikës së çarjes. Historia i dha të drejtë, sepse maska i ra Jugosllavisë më 1989, e bashkë me këtë maskë ra edhe autonomia e Kosovës. Një vit mbrapa, Demaçi doli nga burgu. Gjithsej i ishin bërë 28 vjet burg. A ka sfidë më të madhe për normalitetin e zakonshëm shpirtëror njerëzor sesa dialektika e lirisë: pas 28 vjetësh sakrifice sublime, del nga burgu dhe gjendesh në prag të pleqërisë, kurse atdheu për të cilin je shkruar ndodhet në situatë më të rëndë sesa kur ke je burgosur! Kapërcimi i kësaj sfide s’ka se si të mos jetë madhështor.

Por prej viteve ‘90 e deri sot, aktiviteti politik i Adem Demaçit mund të thuhet se e realizon kalimin cilësor prej dialektikës së çarjes në filozofinë e pajtimit progresiv. Kur doli nga burgu Demaçi ishte figura e përkryer politike e cila mund të krijonte projekt mobilizues, strukturë organizative dhe program politik për Kosovën. Por kishte një problem: Demaçi nuk ishte më ai i pakompromis. Prandaj në fillim ai e përkrahu LDK-në. Shkëlzenin në libër tregon se shumë figura të rëndësishme politike dhe ish të burgosur politikë iu bashkuan LDK-së vetëm pasi Demaçi nuk ndërmori asgjë politikisht dhe u sugjeroi t’i bashkëngjiteshin LDK-së. Atëherë kur Demaçi vendosi t’i kundërvihej LDK-së pas vitit 1995, ishte shumë vonë: mbeti i pafuqishëm kundër iluzionit për krijimin e të cilit kish kontribuar vetë. Dhe iluzioni ishte bërë më i fuqishëm se Demaçi. Shumica e popullit ishte me LDK-në e cila prej zyrave jashtë të cilave endeshin mjetet e blinduara të okupatorit serb na tregonte se qysh ne jemi de facto shtet dhe të pavarur. Dikur kishte çjerr maskën e një regjimi të përbindshëm, e tash s’po mund ta lëvizte nga vendi iluzionin e popullit të vet. Duhet të jetë ndjerë në siklet të madh. Kur Demaçi filloi të mendonte për lirinë strategjiksht, në mënyrë që ta sfidonte LDK-në me alternativën e vet autentike politike, doli me një kompromis aspak të zgjuar: projektin Ballkonia. Ishte ky shembull i mjaftueshëm që tregonte për zhytjen e Demaçit politikan në ujërat e turbullta të logjikës progresiviste. Pra, le t’i tregojmë bashkësisë ndërkombëtare që ne jemi të gatshëm të qëndrojmë nën një kulm të përbashkët me Serbinë, vetëm duke qenë anëtarë të barabartë të familjes. Në kohën kur Rugova po ndëronte pavarësi prej fjalëve brenda realitetit robërues, Demaçi pa forcë doli me zgjidhjen që si fjalë tingëllonte më e butë sesa oferta e LDK-së.

(vazhdon në faqen tjetër)

(vazhdon nga faqja e tretë)

UÇK-ja si strukturë doli jashtë hapësirës dhe kontrollit të këtyre dy figurave politike. Në këtë biografi Shkëlzeni na e sjell një të dhënë shumë të vlefshme për parakushtin e përfshirjes së Demaçit si udhëheqës të Zyrës Politike të UÇK-së. Ai u kishte kërkuar strukturave udhëheqëse ushtarake të UÇK-së që ta bënin "ata luftën e unë politikën". Por, ashtu siç pritej, kur erdhi çasti kritik hegelian i ndërmjetësimit të jetës nëpërmjet vdekjes, i lirisë së pakompromis dhe i substancës së aktualitetit që del si rezultat i shterjes së çarjes dhe përplasjes, Demaçi mbeti i vetmuar. Ata që jetën e çmonin mbi gjithçka tjetër, e kërcënuan Demaçin. I pafrikësuar, por i pafuqishëm për nga mundësitë, ai dha dorëheqje nga Zyra Politike e UÇK-së nga pamundësia që t'i ndalte udhëheqësit e UÇK-së për ta nënshkruar Rambujenë. Politikanët e UÇK-së e pranuan një kompromis për të cilin u pajtuan të gjithë. Edhe ata që nuk u pajtuan, u pajtuan ndryshe, sepse vetëm u tërhoqën. Që prej asaj dite, Kosova iu ka nënshtruar një aktualiteti që nuk derivohet prej përplasjeve fundamentale dhe përpjekjeve substanciale, por fushës së kompromisit konsensual. Sot e kësaj dite ne po e jetojmë një aktualitet të tjetërsuar, josubstancial, realitetin e varësisë së jashtme dhe të pasigurisë së brendshme – aktualitetin e papërbushur të përpjekjes së lënë përgjysmë.

Çarja irlandeze

Kur Sinn Fein-i dhe Ushtria Republikane e Irlandës (IRA) në mënyrë të armatosur morën nën kontroll Postën e Dublinit gjatë Kryengritjes së Pashkëve (Easter Rising), aty e shpallën Republikën e Irlandës. Ata nuk arritën ta mbanin Postën më shumë se pesë ditë, për shkak se forca të mëdha britanike e rivendosën kontrollin dhe e filluan burgosjen, dënimin dhe pushkatimin e kryengritësve për liri. Dy prej figurave të spikatura të rezistencës, Eamon De Vallera nga Sinn Fein-i dhe Michael Collins nga IRA, shpëtuan vetëm me burg. Pasi dolën nga burgu në "liri", vazhduan së organizuari njëjërën prej luftërave më të suksesshme guerile, e njohur si Lufta për Pavarësi (me përqendrim në vrasjen e kolaboracionistëve, shënjestrimin e figurave zyrtare, sabotimin dhe shkatërrimin e institucioneve të pushtetit britanik etj.), duke e detyruar njërin prej shteteve më të fuqishme të botës, por të sapodalë nga lufta rraskapitëse botërore, që të kërkonte negociata për zgjidhjen e statusit të Irlandës së okupuar.

Në negociata vajti Michael Collins. Pas disa muajsh u kthye së bashku me Marrëveshjen për Shtetin e Lirë të Irlandës (*Free State of Ireland Agreement*). Marrëveshja përmbante katër kompromise, të cilat Collins-i i quante "të dhimbshme" por "të domosdoshme" për

ta fituar shtetin irlandez. Këto kushte përfshinin: (a) mbetjen e gjashtë komunave të veriut të Irlandës nën sovranitetin britanik (atëherë nuk kishte decentralizim); (b) nëndetëset ushtarake britanike të mund të qarkullonin nëpër ujërat e Shtetit të Lirë të Irlandës dhe të kishin të drejtë të qëndronin në portet e caktuara të Irlandës, të përcaktuara në Marrëveshje; (c) Shteti i Lirë i Irlandës të mbetej formalisht pjesë e Federatës Britanike (Commonwealth-it), ashtu si Australia, Zelanda e Re, Kanadaja etj.; dhe (ç) që zyrtarët dhe deputetët e Kuvendit të Shtetit të Lirë të Irlandës t'ia bënin betimin Kurorës së Mbretëreshës.

De Vallera i kundërshtoi kompromiset e Collins-it, duke e quajtur Marrëveshjen tradhti ndaj shpalljes së Republikës së Irlandës më 1916. Por në Parlamentin e atëhershëm, Marrëveshja kapërcen për 4 vota (61:57 pro Marrëveshjes). Organizohen edhe zgjedhjet e parakohshme. De Vallera i humb zgjedhjet. Ai e bojkoton Kuvendin me moton "shumica nuk ka të drejtë të gabojë!", dhe e fillon rezistencën e tij kundër Collins-it. Ky është çasti i çarjes së IRA-s. Prej 22.000 ushtarëve e oficerëve të saj, 15.000 ishin kundër Marrëveshjes, dhe vetëm 7.000 pro.

Në anën tjetër, Michael Collins, bashkëluftëtari dhe shoku i dikurshëm i de Vallera-s, merr të gjitha masat për zbatimin e Marrëveshjes. Të mos harrojmë që Marrëveshja parashihte edhe themelimin e Ushtrisë Kombëtare (njëfarë FSK-je e atëhershme e pajisur me armatim të lehtë), Gjeneral i të cilës u bë vetë Michael Collins. Pjesa e IRA-s së çarë që e mbështeste Marrëveshjen, u shndërrua në këtë Ushtri Kombëtare. Mbretëria e Bashkuar nëpërmjet Winston Churchill-it, atëherë Ministër Britanik i Mbrojtjes, mbështet Collins-in kundër de Vallera-s, në përpjekjen e Shtetit të Lirë të Irlandës për shtrirjen e kontrollit sipas Marrëveshjes, dhe ndëshkimin e çdo të pabinduri nëpërmjet gjuhës së forcës. Por që të dy zhvillojnë fushata për ta bindur popullin irlandez: njëri për domosdoshmërinë e Marrëveshjes, për kurorëzimim e vullnetit të popullit, për realizimin e aspiratës shumëshekullore të Irlandës për pavarësi; tjetri për shkeljen e Collins-it mbi gjakun e dëshmorëve, për tradhti, për ndarjen e Irlandës dhe lënien e veriut nën Britani.

De Vallera arrin ta marrë Kuvendin me njerëzit e tij të armatosur, por Ushtria Kombëtare e Collins-it e rivendos kontrollin kundër njerëzve të de Vallera-s, ashtu siç dikur e kishte marrë Britania kundër të dyve. Dhe fillon ndjekja e atyre "të jashtëligjshmëve". Collins-i, gjatë një udhëtimi për në vendlindjen e vet Cork, në përpjekje për ta takuar de Vallera-n, dhe për të biseduar me të, bie në pusinë e organizuar nga njerëzit e këtij të fundit dhe vritet në moshën 31 vjeçare. Ky është çasti kur fillon Lufta Civile e Irlandës mes dy krahëve të IRA-s së çarë.

Institucionistët kishin më shumë mundësi

ushtarake e organizative. Collins-in tashmë të ndjerë e zëvendëson Richard Mulcahy, i cili e nis një fushatë mizore kundër krahut të de Vallera-s, përgjatë një lufte të përgjakshme civile, në të cilën vriten mbi 3.800 veta (3000 të IRA-s kundër Marrëveshjes; 800 të Ushtrisë Kombëtare). Lufta Civile merr fund me fitoren e Ushtrisë Kombëtare kundër IRA-s së de Vallera-s. De Vallera futet në burg, oficerët kryesorë të tij pushkatohen.

Pasi del nga burgu, de Vallera i kthehet Sinn Fein-it, organizatë politike kjo e cila identifikohet si strumbullari politik i rezistencës kundër Marrëveshjes, por tashmë e shkapërderdhur dhe e dobësuar pas humbjes së Luftës Civile. Ai nuk mund ta bindë udhëheqësinë e Sinn Fein-it për ndryshimin e politikave pas humbjes së Luftës Civile, duke e propozuar strategjinë e re të ndryshimit të institucioneve dhe pezullimin e Marrëveshjes nëpërmjet zgjedhjeve dhe hyrjes në institucione. Prishet me Sinn Fein-in që nuk e pranon këtë projekt, dhe më 1926 e themelon partinë e vetpolitike Fiona Fail. Partinë e mbështet mbi ligjërimin kritik kundër Marrëveshjes, duke i paraqitur të gjitha problemet me të cilat ndeshet Shteti i Lirë i Irlandës si rrjedhojë e drejtpërdrejtë e Marrëveshjes, duke filluar që prej problemeve politike e deri te ato sociale e ekonomike. Ai i premtonte popullit irlandez se po ta votonin partinë e tij, do ta pezullonte Marrëveshjen. Falë kësaj strategjie, në vitin 1932 Fianna Fail arrin t'i fitojë zgjedhjet irlandeze. De Vallera hyn në Kuvend me deputetët e tij që përbënin shumicën, e pezullon Marrëveshjen, ndërron Kushtetutën, heq betimin ndaj Kurorës, shpall Republikën e Irlandës dhe zgjidhet President i saj.

Që prej asaj kohe, skena politike irlandeze është strukturuar përreth trashëgimisë politike të këtyre dy figurave. Vija politike që mbështeste Marrëveshjen u riorganizua në partinë politike Fine Gael. Fianna Fail dhe Fine Gael janë dy partitë kryesore të Irlandës edhe sot e kësaj dite. Por mbi 80% të zgjedhjeve i ka fituar partia e identifikuar me përpjekjen e Eamon de Vallera-s, parti kjo e cila edhe sot e kësaj dite e mban pushtetin politik në Irlandë (pandërprerë që prej vitit 1998).

Në fund të filmit të Neil Jordan-it *Michael Collins* (1996), i cili i trajton zhvillimet kronologjikisht deri në prag të Luftës Civile, pra deri te vrasja e Collins-it, jepen pamjet e vërteta prej varrimit të tij dhe qëndrimi i regjisorit: "Historia i ka dhënë të drejtë Michael Collins-it". Po të mos jepej ky qëndrim, nuk do ta dinit se regjisorit është anglez. Por nga perspektiva hegeliane, historia i ka dhënë të drejtë Eamon de Vallera-s. Nëse historia madhështore irlandeze merret si tërësi e përpjekjes për liri, ku secili moment situohet pazëvendësueshëm përbrenda ecjes përpara, atëherë veçantia e fytyrës kombëtare irlandeze është identifikimi me të drejtën, jo me mundësinë; me aktin, jo me procesin; me skajin, jo me kompromisin; me

menjëherësinë, jo me gradualitetin. Nëse historia i dha të drejtë Collins-it, i dha vetëm aq sa të shërbente si urë kalimi. Por nuk mund të ketë identifikim me urën. Nuk mund të jetë ura identiteti i një kombi. Asnjëherë qëllimi nuk është vetë ura, por liria që gjendet në anën tjetër.

Kur Collins-i foli në Kuvend për ta arsyetuar Marrëveshjen që solli prej negociatave, ai tha: "Po edhe nëse është e thënë që rruga e Irlandës deri te pavarësia e plotë të kalojë patjetër mbi trupin tim të vdekur, le të jetë ashtu". Dhe profecia u realizua: liria përnjëmend nuk mund të vinte përveçse përmbi Collins-in e vdekur. Sot kurrë nuk mund ta dimë me saktësi objektivitetin e rrjedhës, po të mos ishte pranuar Marrëveshja: çka do të ndodhte me Irlandën, ku do të mbetej de Vallera, cili do të ishte fati i veriut...? Mirëpo kombi kurrë nuk ndërtohet mbi hamendjen objektive, por mbi zotimin subjektiv. Ndoshta irlandezët në vetëkonceptin e tyre kombëtar e shohin rëndësinë historike të Collins-it po aq definitive sa atë të De Valleras. Por formacioni identitar irlandez ndërtohet duke u identifikuar me lirinë joprogresive, ultimative, të pakompromis, si dhe me përpjekjen që duket e skajshme po u shikua nga pozita e kompromisit.

Sa herë kaloj nëpër këtë pjesë të shkëlqyeshme të historisë irlandeze të luftës për pavarësi, më duket sikur po e lexoj aktualitetin e munguar të versionit shqiptar, figura qendrore tragjike politike e të cilit është Adem Demaçi. Ai nuk është De Vallera shqiptar. Meqë nuk ishte i tillë, përfundoi në përqaqim të një sistemi politik, drejtësinë e të cilit e ndajnë ata që e dënuan politikisht Demaçin, sistem ky që Adem Demaçit ia jep pensionin. Kurrëgjë e re për historinë tonë skizofrenike: Ahmet Zogu dorë për dore me Hasan Prishtinën, Fadil Hoxha me Shaban Polluzhën, Mahmut Bakalli me Adem Demaçin, Azem Vllasi me Hydajet Hysenin, Ibrahim Rugova me Adem Jasharin...

Po nëse Adem Demaçi vetëm u përpoq, nëse ai nuk e ndoqi deri në fund filozofinë e çarjes substanciale, çka bëme ne të tjerët? Ne që, ndërsa Demaçi fliste me insekte, të paktën flisnim me njëri-tjetrin. Ne që herë-herë i ktheheshim jetës sonë të përditshme, normalitetit të saj pëshpëritës, kënaqësive familjare dhe çmalljes miqësore, atëherë kur mbi të rëndonte pesha e plumbtë e vetmisë. Ne që, kur ta shikojmë veten në pasqyrë, duhet të përkulemi me respekt të thellë përpara këtij njeriu madhështor.

Gjithmonë kam pas dashur të shkruaj për Adem Demaçin, si për epiqendrën e rezistencës shqiptare në Kosovën e gjysëmshkullit të shkuar, rreth të cilës vërtitet një dyzinë aktivistësh e dëshmorësh, të burgosurish politikë e organizatash ilegale. Por këtë gjë munda ta bëj vetëm pasi lexova librin e Shkëlzen Gashit – Adem Demaçi: Biografi. Nuk po them gjithsesi blejeni këtë libër. Por patjetër lexojeni atë.

Lëvizja VETËVENDOSJE! është komunitet i njerëzve që refuzojnë të nënshtrohen. Ajo synon arritjen dhe realizimin e vetëvendosjes për popullin e Kosovës. Lëvizja VETËVENDOSJE! angazhohet edhe për ndryshime radikale shoqërore e politike që do të mundësonin respektimin e të drejtave të njeriut, të drejtave civile dhe drejtësisë sociale për të gjithë dhe secilin në Kosovë pa kurrfarë diskriminimi.

VETËVENDOSJE!
KOPJIMI LEJOHET.
TË LUTEM, KOPJOJE!

Rr. "Perandori Justinian" nr. 9
Qyteza Pejton
Prishtinë, Kosovë
038 222 704
+37744509858
lvetevendosje@gmail.com
levizjavetevendosje@yahoo.com
www.vetevendosje.org